

KREMTIMI I SHKOLLËS SHQIPTARE NË KAIRO TË EGJYPTIT¹

Ky është titulli i një rivishte patriotiko-satirike, që nxënësit e shkollës të Bashkësisë Shqiptare në Egjypt dhanë më 27 nëntor, në një sallë të udhës “Besa” në Kairo.

Më se 150 shqipëtarë u mbledhë familisht, që të vështrojnë veprën që do të luhej për të parën herë. Zoti Vasil Thomaidhi, Kryetar i Bashkësisë, zoti Koço Donato, Sekretar dhe zoti Vangjel Qirko, Këshilltar, kishin ardhur enkas nga Aleksandria.

Me të vërtetë, ish fort e vështirë për një shkollë që numëron gjashtë muaj jetë dhe me propagandën kundërshtare të disave që përdorin çdo mënyrë, jo fisnike, që të ndalojnë fëmiën të lozin, ish fort e vështirë themi vepra që mori përsipër zoti Milo Duçi, mësuesi i shkollës. Por, me patriotizmin të flaktë që ka dhe vullnetin të hekurtë që karakterizon, zoti Duçi kapërceu çdo ndalim dhe u paraqit përpara publikut me nxënësit e tij të mbaruar në rolet e tyre.

Kremtimi nisi ora më 7 m. d. me një fjalë të shkurtër nga mësuesit për të gjetëuar gjithë sa nderuan kremtimin dhe veçanërisht, për të shfaqur mirënjohjen e tij kundra Bashkësisë për themelimin të shkollës dhe interesin që nuk pushojnë të tregojnë kundrej saj. Përfundoj duke kërkuar mëshirën e të ndodhurve për nxënësit, nëqoftëse nuk dot’ jenë në lartësinë të rolleve tyre.

Iu përgjegj nga ana e Bashkësisë zoti Koço Donato duke gjetëuar mësuesin për zellin dhe mundimet që ka për mirvajtjen e shkollës, dhe duke shfaqur gëzimin dhe kënaqësinë që sheh djalmurinë shqipëtare të mësojnë gjuhën e tyre amtare, ndose gjenden lark atdheut dhe mbaroj duke premtuar ndihmë më të madhe pas këtaj.

Më ora 8 u hap shena që të hyjë e Bukur e Dheut (zsha. Afërditi Ikonomi) dhe të nisë lodra, që kororos me sukses të plotë. E mshtjellë në flamur, kryelartë dhe madhështore, Shqipëria (zsha. Despina Petassi) dha nështypjen të një patriote që ndjen në fund të zemrës rrollin e saj, Korça

1 Arkiva e Shtetit, F. 195, U 33, D 60.

(zsha. Bubuka Popoviç), Lushnja (zsha Margarita Djello), Vlora (Liria Konomi), Kruja (Aliqi Krej), Shkodra (Fanny Dossi), Himara (Nelly Vito), Gjirokastra (Liria Ananezi) dhe Olga Spiro si Sazani, lojtnë si jo më mirë. Sa për Përmetnë (Vangjelia Konomi), e paimtuar në rollin të evgjinit. Nga ana e djemve, Leshi (Gjon Duçi), Mati (Peçi Konomi), Çamëria (Gaqi Konomi), Tivari (Petro Djello), Prizreni (Aleks Duçi), mallëngjueu të gjithë, kur tha një vjershë të flamurit.

Në mbarim, nxënësit kënduan “Rreth flamurit” dhe pas këti, një hymn të pëlqyer, të ngrehur enkas për L. M. e Tij. Zogu I, Sovranë tonë, pregatiti Milo Duçi dhe të muzikuar nga Zonja e tij.

Pas theatros, çupat të Shkollës shërbyen me konjak dhe ëmbëlsira, dhe pastaj, nënë ushëtim të Jaz-Bandës, sjellë miqësisht prej zotit Dodi Kozma Sotiri, nisë vallet dhe qefi mbajti gjer në mëngjes.

Vula: Krye-Konsullata e Mbretërisë Shqiptare – Aleksandrie

* Dokumenti i mësipërm i është dërguar Ministrisë së Arsimit në Tiranë, prej Kryekonsullatës së Mbretërisë Shqiptare në Aleksandri dhe mban datën 21 Dhjetor 1933. Bëhet fjalë jo vetëm për shfaqjen artistike me karakter patriotik të vënë në skenë nga brezi i ri i kolonisë shqiptare të Egjiptit, por edhe për ekzistencën e një shkolle ku ata mësonin gjuhën amtare, për të mbajtur kështu të gjallë ndjenjën kombëtare. Për hir të së vërtetës duhet thënë se Kolonia e shqiptarëve në Egjipt ka qenë jashtëzakonisht aktive në dobi të çështjes kombëtare duke nisur nga gjysma e dytë të shekullit të 19.

